

NJË GUIDË E EKONOMISË BOTËRORE

Tetëdhjetë e një koncepte ekonomike

kryesore që do të ndryshojnë

këndvështrimin tuaj ndaj botës

Nëse ekonomistët duan të jenë të kuptueshëm, duhet të përdorin fjalë të thjeshta...(dhe) këto fjalë tua drejtojnë më tepër njerëzve të tjerë sesa politikanëve. Politikanët shqetësohen për atë çka mendojnë votuesit, veçanërisht ata në grupe dhe aspak për atë çka mendojnë ekonomistët. Pra, t'u flasësh politikanëve mbi ekonominë është humbje kohe. Mënyra e vetme për ti bërë qeveritë të sillen sikur ato marrin vesh nga ekonomia është ti përballësh ato me elektoratin e tyre.

- The Economist

PËRMBAJTJA

Hyrje	11
1. Ç'është ekonomia botërore?	21
2. Çfarë e përcakton shpërndarjen e pasurisë nëpër botë?	22
3. Ç'është makroekonomia?	25
4. Si funksionon tregtia ndërkombëtare?	27
5. Ç'është globalizimi?	29
6. Çfarë janë sufiçiti e defiçiti tregtar?	32
7. Ç'është paraja?	34
8. Cilat janë monedhat kryesore të botës?	38
9. Ç'është euro-ja?	40
10. Ç'është paraja virtuale?	42
11. Çfarë janë monedhat me vlerë të ndryshueshme këmbimi?	46
12. Çfarë janë kurset e këmbimit?	48
13. Ç'është GNP-ja/GDP-ja?	50
14. Si krahasohen ekonomitë e vendeve të ndryshme?	52
15. Ç'është oferta e parasë?	55
16. Ç'është inflacioni?	57
17. Ç'është një bankë qendrore?	59

18. Si e bëjnë rregullimin e ekonomisë bankat qëndrore?	62
19. Si përdoren përqindjet e interesit me synimin për të kontrolluar rritjen ekonomike?	65
20. Ç'është tregtia e lirë?	66
21. Çfarë janë kuotat, tarifat e subvencionet?	69
22. Ç'është OBT-ja?	71
23. Kush investon në tregun global?	74
24. Ç'është ekuiteti?	76
25. Ç'kuptim kanë shkurtimet Ltd., Inc., GmbH, dhe S.A.?	77
26. Ç'është bilanci?	80
27. Ç'është bilanci i humbjeve dhe bilanci i fitimeve?	82
28. Ç'është pasuria neto?	84
29. Ç'është falimentimi?	86
30. Ç'është kapitali <i>venture</i> ?	88
31. Ç'është një IPO?	90
32. Ç'është një <i>leveraged buyout</i> ?	94
33. Çfarë janë multinacionalet?	96
34. Cilat janë rreziqet e investimeve ndërkombëtare?	99
35. Ç'është indeksi i aksioneve?	102
36. Në ç'mënyrë investitorët blejnë aksione të huaja?	107
37. Ç'është një fond ekuiteti?	110
38. Ç'është një treg kapitalesh?	112
39. Ç'është një obligacion?	113
40. Çfarë janë euro-monedhat dhe euro-obligacionet?	117
41. Çfarë janë klasifikimet, mbi bazën e të cilave vlerësohen investimet ndërkombëtare?	118
42. Në ç'mënyrë ari është pjesë e ekonomisë botërore?	120
43. Çfarë janë derivativat?	122
44. Ç'është <i>opsioni</i> ?	123
45. Çfarë janë opsionet e premtimeve (<i>stock options</i>)?	126
46. Ç'është një opsion i monedhës (<i>currency option</i>)?	128
47. Ç'është një fond "hedge"?	130
48. Çfarë janë paratë "hot"?	131

49. Ç'është "New Economy"?	134
50. Si mund të krahasohen kompanitë "New Economy" me kompanitë tradicionale?	137
51. Ç'është <i>e-commerce-i</i> ?	141
52. Ç'është Bashkimi European?	144
53. Si i ka transformuar kapitalizmi vendet komuniste?	147
54. Si po integrohet ish-blloku sovjetik në ekonominë botërore?	151
55. Ç'janë ekonomitë "tigra" të Azisë Juglindore?	153
56. Ç'është Japan Inc.?	155
57. Ç'është Bota e Tretë?	157
58. Ç'është hiperinflacioni?	159
59. Çfarë e shkakton hendekun e të ardhurave midis vendeve të varfëra e vendeve të pasura?	162
60. Çfarë mund të bëhet për të nxitur zhvillimin e Botës së Tretë?	165
61. Ç'është Banka Botërore?	169
62. Ç'është FMN-ja?	172
63. Ç'është planifikimi rigoroz ekonomik?	173
64. Ç'është dollarizimi?	175
65. Ç'është NAFTA?	177
66. Çfarë janë mega-zonat e tregtisë së lirë?	179
67. Çfarë janë OECD-ja dhe G7/G8?	181
68. Çfarë janë bankat e zhvillimit rajonal?	184
69. Çfarë roli luajnë në ekonominë botërore organizatat e bamirësisë dhe OJQ-të?	186
70. Në ç'mënyrë korrupsioni është pjesë e ekonomisë botërore?	188
71. Ç'është pastrimi i parave?	190
72. Si funksionon një llogari bankare zvicerane?	193
73. Çfarë janë parajsat fiskale?	196
74. Si tregtohen mallrat ilegale në tregjet e zinj të botës?	198
75. Ç'është spiunazhi ekonomik?	202
76. Sa dhe si ndikohet mjedisi prej ekonomisë botërore?	204
77. Si mund të përdoren incentivat ekonomikë për të reduktuar ndotjen?	207
78. Si dhe sa ndikon emigracioni në ekonominë botërore?	210
79. Në ç'mënyrë janë pjesë e ekonomisë	

botërore skllavëria dhe shfrytëzimi i fëmijëve?	213
80. Ç'efekt ka epidemia e AIDS-it në ekonominë botërore?	216
81. Çfarë janë sanksionet ekonomike?	219
Fjalor	222

HYRJE

KU PO SHKON BOTA E SOTME? Në Seattle, policia arreston njerëz dhe i sulmon me gaz lotsjellës, ngaqë ata protestojnë kundër Organizatës Botërore të Tregtisë. Në Francë, një grua vritet, teksa terroristët “antiglobalistë” hedhin në erë një lokal McDonald’s. Një numër kompanish nëpër të gjithë botën po bojkotohen, ngaqë s’pagojnë siç duhet punëmarrësit e tyre të Botës së Tretë. Turma të egërsuara antiglobaliste pengojnë mbajtjen e summit-eve ekonomike në Washington, në Pragë, në Davos, në Melburn.

Një ide interesante lidhur me faktin, se ku po na çon kjo lëvizje antiglobaliste, mund të krijohet në Portland të Oregon-it, ku së fundi, ulja e taksave për t’u ardhur sipas midesë votuesve i detyroi shkollat lokale të mbyllin veprimtaritë ekstra kurrikulare, përfshirë një numër programesh sportive të shkollave të mesme. Një prodhues lokal i këpucëve sportive, aktiviteti ekonomik i të cilit ishte global, vendosi t’i nxjerrë nga vështirësia këto shkolla nëpërmjet një donacioni prej disa milionë dollarësh. Nxënësit u entuziazmuan, por një nga anëtarët e bordit të shkollës refuzoi të pranonte paratë, ngaqë ato vinin nga një kompani, që po “shfrytëzonte” punëtorët e vendeve të varfëra. Unë u ndodha në Portland në atë kohë, dhe një grup qytetarësh të shqetësuar m’u qasën e më kërkuan të nënshkruaja një peticion, nëpërmjet të cilit donin të rrisnin taksat mbi – merret lehtë me mend – korporatat lokale, dhe kështu të mund të nxirrnin nga vështirësitë shkollat në nevojë për pará. “Ne nuk duam të taksojmë njerëzit”, më garantuan ata, “ne duam të taksojmë bizneset, sidomos ato biznese që fitojnë pará në mënyrë imorale duke i paguar punëtorët e huaj me vetëm 1\$/orë.”

Mendimi ekonomik i paqartë dhe i hutuar edhe mund të falet, por kur ai shkakton pasoja të paparashikuara për të varfërit në anën tjetër të botës, mund të jetë shkatërrimtar. Përfytyroni për një çast një situatë, sipas së cilës ju bashkë me familjen jetoni në mjerimin e një qyteti të mbipopulluar të Botës së Tretë, dhe një ditë prej ditësh gjeni punë të paguar relativisht jo keq në një fabrikë të hapur nga një investitor i huaj; përfytyroni sikur boss-i juaj t’ju vijë e t’ju thotë, se do ta mbyllë fabrikën, ngaqë e ka të vështirë të bindë protestuesit e vendeve të pasura mbi faktin, që një dollar në orë është një goxhá pagesë për një vend, ku një familje e tërë mund të jetojë me vetëm pak dollarë në ditë.

Nuk ka dyshim, se çdo pjesëmarrës në ekonominë botërore ka përgjegjësinë të jetë syçelët, në mënyrë që punëtorët dhe fëmijët të mos shfrytëzohen dhe që askush të mos jetë i shtrënguar të bëjë një punë, e cila është e papërshtatshme për të. Dhe secili syresh lipset të verifikojë, nëse kompanitë respektojnë të drejtat bazë të punëtorve dhe mjedisin. Por të thuash që pagesa prej 1\$/orë është “imorale”, pa marrë parasysh në këtë mes background-in ekonomik, është – në rastin më të mirë – një gjë krejt e pamend. A mos është gjë imorale që një mësues në Dakotën e Jugut paguhet me 29 000\$/vit ndërsa një mësues në Connecticut paguhet me 52 000\$/vit?

Globalizimi ...hendeku i të ardhurave midis të pasurve e të varfërve ...luftat tregtare ... New Economy. Gjatë viteve të fundit, në ekonominë botërore ka ndodhur një shpërthim virtual kompleksiteti, dhe neve po na kërkohet ta kuptojmë atë tërësisht. Fjalë dhe fraza të llojit “hedge funds”, “OBT”, “stock options”, dhe “sanksione ekonomike” shfaqen rregullisht në ditarët informativë, dhe shumë prej nesh as që e kanë idenë se për çfarë është fjala.

Por, nëse duam t’ia dalim mbanë në këtë “new economy” botërore, ne duhet të jemi të aftë – të paktën – të kuptojmë gjërat bazë. Kushdo qofshim – ambientalistë apo fermerë, nxënës të shkollave së mesme apo njerëz të biznesit, gra shtëpiake apo aktivistë sindikatash – nëse duam të jemi qytetarë e konsumatorë të përgjegjshëm, ne duhet të nxëmë gjërat fillestare në fushën e ekonomisë.

E megjithatë, për shumëkënd prej nesh, studimi i ekonomisë ka qënë një ushtrim i kotë dhe i padobishëm, i mbushur me diagrama dhe ekuacione të paqarta, për të cilat as që kemi shpresuar se mund të kenë ndonjë lidhje me jetën tonë të përditshme. Por në fakt, nuk është tamam kështu. Realisht, ekonomia botërore nuk është më e komplikuar se sa ekonomia shtëpiake, me të cilën merremi ditë për ditë. Ne nuk është se mendohemi dy herë, kur vjen puna për të shkuar në anën tjetër të rrugës e për të depozituar paratë tona në një bankë, e cila ka norma interesi më të mira se sa banka ngjitur me derën e shtëpisë sonë. Në një ekonomi të shtrirë globale, nuk kemi pse të mendohemi dy herë, kur vjen puna për të kaluar kufirin me synimin për të investuar paratë apo për të shitur mallrat e shërbimet tona.

Interneti dhe mundësi të tjera që lehtësojnë komunikimin e shpejtë ndërkufitar po e bëjnë të mundur që ekonomia botërore na prek jetët tona në ca mënyra, të cilat kanë qënë të panjohura deri pak vite më parë (duke filluar me vendet e reja të punës, mallrat, shërbimet e deri tek kërcënimet që i bëhen mirëqënies sonë ekonomike). Duke kuptuar bazat e ekonomisë botërore, ne do të jemi në gjendje të marrim vendime më të mira në funksion të përcaktimit të kursit të kësaj bote. Dhe nën trysinë e votuesve që kanë nxënë gjërat fillestare në fushë të ekonomisë, politikanët do të fillojnë të marrin gjithashtu vendime ekonomike më racionale, gjë që do ta bëjë botën e viteve të ardhshme më të mbrothët, e ndoshta, me një ndërgjegje më të mirë sociale e më të sigurtë në pikëpamje ambientale. Në këtë botim të ri të “Guidës së ekonomisë botërore për fillestarë”, unë kam përfshirë komente të shumta të lexuesve (mund të më shkruani në çdo moment në adresën elektronike RCEpping@aya.yale.edu.). Shumë lexues nga e gjithë bota, punëtorë që merren me programet e asistencës për Botën e Tretë, profesionistë të *e-commerce*-it, studentë, funksionarë, e kanë përmendur këtë libër si instrumentin e tyre ndihmës në përpjekjet për të hedhur hapat e para në lëmin e ekonomisë globale. Kushdo qofshim e kudo jetofshim, nëse do të gjendeshim të përfshirë në ekonominë botërore, ne do të kishim nevojë të kuptonim bazat e kësaj ekonomie. Dhe herët apo vonë, në një mënyrë apo në një tjetër, ne do ta gjejmë veten të përfshirë.

Ju bëj me dije, se kjo s’do të thotë se kemi të bëjmë me një libër që të mëson se si “të bëhesh i pasur sa hap e mbyll sytë”; ky libër nuk do t’ju mësojë juve në cilën *dot-com* të huaj duhet të investoni paratë tuaja apo se si të bëni zap tregjet financiare ndërkombëtare. Çdo sulm në drejtim të tregut global duhet të shoqërohet me dije të hollësishme të parimeve, mbi të cilat tregjet globale janë ngritur. E përfytyroni dot veten, teksa përpiqeni të investoni në një ofertë të parë publike (IPO – initial public offering) të *e-commerce*-it pa ditur fillimisht gjë prej gjëje lidhur me internetin?

Unë shpresoj që ju ta shijoni këtë libër. Ka qënë argëtuese për mua, ndërsa e shkruaja, e duhet të jetë argëtuese për ju, ndërsa do ta lexoni. Unë nuk kam përdorur diagrama e ekuacione, dhe statistikat janë vazhdimisht të shoqëruara me shembuj, të cilët u japin kuptim numrave.

Një Guidë e Ekonomisë Botërore për Fillestarë, siç e thotë dhe emri, do të merret vetëm me konceptet bazë, të cilat ju i hasni në jetën tuaj të përditshme. Me teori e parime të komplikuar ekonomike janë marrë e do të merren të tjerët.

Nga t’ia nisësh? Edhe pse mund të jetë frutdhënëse t’ia nisësh me konceptet e përgjithshme ekonomike, të cilat gjenden në fillim të librit, secili kapitull mund të lexohet më vete. Libri mund të

lexohet nga fillimi në fund apo nga fundi në fillim, por nga ana tjetër, kapitujt për t'u lexuar mund të zgjidhen edhe kuturí, në varësi të interesit të secilit. Fjalori në fund të librit mund të përdoret gjithashtu për referenca të shpejta, në rastet kur terma jo dhe aq familjarë shfaqen në rubrikat e lajmeve, në web, apo në bisedat e përditshme.

Ekonomia botërore mund të kuptohet lehtësisht. Me të kuptuar bazat, ekonomia globale mund të shndërrohet në një aventurë të madhe, ku vende e njerëz të huaj ndërveprojnë në mënyrë magjepsëse. Mjafton që gjërat të shpjegohen thjesht. Shijojeni këtë libër!